



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË
INDUSTRIËS DHE ENERGJISË**

Nr. 5 / 7 prot.

Tiranë, më 19 3 .2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes minerare nr.1243, datë 29.09.2008.

SHOQËRISË "FRALI" SHPK
Lagjia: "Sheq i Madh", Fier

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë

Shoqëria "Frall" shpk është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1243, datë 29.09.2008, për mineral gur gëlqeror pllakor, në objektin "Kalivaç", Tepelenë.

Nga struktura përgjegjëse AKBN, me shkresën nr.5828, datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5408, datë 01.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1243, datë 29.09.2008, për mineral gur gëlqeror pllakor, në objektin "Kalivaç", Tepelenë, për arsye se nuk janë kryer pagesat e rehabilitimit vjetor për vitin 2013-2014, për vitin 2014-2015 dhe për vitin 2015-2016, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Leja nr.1243, datë 29.09.2008, është dhënë në përputhje me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, "Minerar të Shqipërisë", të ndryshuar, që është shfuqizuar me ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germen "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje

revokohet) të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për sa më sipër në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1243, datë 29.09.2008, për mineral gur gëlqeror pllakor, në objektin “Kalivaç”, Tepelenë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë të ditur se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1243, datë 29.09.2008, për mineral gur gëlqeror pllakor, në objektin “Kalivaç”, Tepelenë

Në zbatim të nenit 49, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

